



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-07/IA003

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 19 mars 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

**Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:**

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtësve të Hysni Gucatit:**

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

**Mbrojtësve të Nasim Haradinajt:**

Tobi Kadman

Karl Bakli

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullave 97(3), 169 dhe 170 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“DHSK”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me apelimet e ndërmjetme të z. Nasim Haradinaj dhe z. Hysni Gucati kundër vendimit<sup>1</sup> të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi mocionet e tyre paraprake (“Apelet”).<sup>2</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 dhe 26 shtator 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj u arrestuan në Kosovë dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë, Holandë.<sup>3</sup>
2. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi pjesërisht aktakuzën kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj, dhe ndër të tjera urdhëroi Zyrën e Prokurorisë së Specializuar (“ZPS”) që të dorëzonte “aktakuzën e rishikuar për herë të dytë”, të konfirmuar.<sup>4</sup>
3. Më 14 dhjetor 2020, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar.<sup>5</sup>
4. Më 8 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë në tërësinë e tyre mocionet paraprake të z. Gucati dhe z. Haradinaj ku pretendonin, ndër të tjera, mangësi në aktakuzën e konfirmuar.<sup>6</sup>
5. Më 18 mars 2021, z. Haradinaj dhe z. Gucati apelian vendimin e kontestuar.<sup>7</sup>

## II. KLASIFIKIMI

6. Apelimet dhe vendimi i kontestuar u protokolluan si konfidenciale dhe ky vendim

do të mbajë të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet në kohën e duhur në përputhje me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

### III. CAKTIMI

7. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

#### **KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:**

**Gjykatësen Mishelë Pikar**

**Gjykatësin Emilio Gati**

**Gjykatësin Kai Ambos**

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur për apelet.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**

**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

---

<sup>1</sup> F00147, Vendim mbi Mocionet Paraprake të Mbrojtjes, 8 mars 2021 (konfidencial) (“Vendimi i Kontestuar”), para. 74.

<sup>2</sup> IA003/F00001, Apel lidhur me Vendimin mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes, 17 mars 2021 (konfidencial); IA003/F00002, Bashkim me Apelin lidhur me Vendimin mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes dorëzuar nga Nasim Haradinaj, 18 mars 2021 (konfidencial).

<sup>3</sup> Shih F00012, Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi, 24 shtator 2020.

<sup>4</sup> F00074/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës, 11 dhjetor 2020, para. 155.

<sup>5</sup> F00075, Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar me Shtojcat 1 dhe 2 Rreptësisht Konfidenciale, 14 dhjetor 2020.

<sup>6</sup> Vendimi i Kontestuar, para. 74. Shih edhe F00113/RED, Version i Redaktuar Publik i Mocionit Paraprak të Mbrojtjes së z. Gucati për Mangësi në Formën e Aktakuzës sipas Rregullës 97(1)(b), 3 shkurt 2021; F00116, Mocion Paraprak në lidhje me Mangësitë në Aktakuzë, 4 shkurt 2021 (konfidencial).

<sup>7</sup> Shih në përgjithësi Apelet.

E premte, 19 mars 2021  
Në Hagë,  
Holandë